



Bordi

VENDIM

Nr. 21, Datë 18.02.2019

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “KASTRATI ENERGY” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE.

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37 pika 2, gërma “ç”, të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “d” nenit 5 pika 1 gërma “d” dhe nenit 10 pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, si dhe nenit 19 pika 1 gërma “a” të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 18.02.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, për licencim e shoqërisë “Kastrati Energy” sh.p.k në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

Konstatohet se:

- Shoqëria “Kastrati Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 111 Prot., datë 01.02.2019, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e Furnizimit të Energjisë Elektrike.
- Aplikimi i shoqërisë “Kastrati Energy” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:
 - Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” dhe “c”). Plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”), Plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacionin financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”). Plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin furnizimit të energjisë elektrike (neni 9 pika 4.7 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “f” dhe pika 4.7.1 gërma “c”). Plotësuar në mënyrë korrekte.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

- Neni 9 Pika 3 gërma “b” (bilanci financiar i tre viteve të fundit).
- Nenin 9 pika 4.7 gërma “e” (Sistemi IT)
- Nenin 9, pika 4.7.1 gërma “a” (Të dhëna për klientët dhe energjinë e furnizuar) dhe gërma “b” (Niveli i tensionit dhe mënyra e realizimit të matjes për klientët),

do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11 pika 1 të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, ti paraqesë ato brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE-s,

Vendosi :

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Kastrati Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit me energji elektrike, për një afat 5(pesë) vjeçar.
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI NË DETYRË

Adriatik BEGO